

Akti i Themelimit

“PANTHEON. RE”

Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (sh.p.k.)

Sot, më datë 30.05.2025 e nënshkruara:

- **Znj. Sonila Banda**, e bija e Albert-it, e lindur më 11/02/1974, banuese në Rruga Dum Alla 441, Tiranë, me kombësi Shqiptare, mbajtëse e kartës së identitetit me numër H45211117N madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

Me vullnetin e lirë dhe në përputhje me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (Ligj i Shoqërive) kanë vendosur të krijojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar **“PANTHEON. RE”** (Shoqëria) duke nënshkruar këtë Akt Themelimi.

Emri dhe forma ligjore

Neni 1.

- 1.1 Emri i shoqërisë do të jetë **“PANTHEON. RE”** ndjekur në mënyrë të pandashme nga shkurtimi “sh.p.k.”, cili përfaqëson formën ligjore të saj.
- 1.2 Shoqëria ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në pajtim me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (Ligji i Shoqërive).

Selia dhe kohëzgjatja


Neni 2.

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Stefan Pano, nr. app. 37, nr. pasurie 43/213/ND+1-37, z.k. 8602, Vlorë. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose në një qytet tjetër të Shqipërisë. Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- 2.2 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj ekonomik për një afat të papërcaktuar. Kohëzgjatja e shoqërisë do të fillojë pas regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe mund të zgjatet ose shkurtet, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve

Objekti i veprimtarisë

Neni 3.

- 3.1 Shoqëria do të ketë si objekt kryesor veprimtarie: Konsulencë Burime Njerëzore, Rekrutime punonjësish, Ndërmjetësime B2B, Agjenci martesash, blerje online ose internet.
- 3.2 Shoqëria mund të bëjë të gjitha operacionet tregtare, industriale, të pasurive të luajtshme dhe të pasurive të paluajtshme, financiare dhe të kredisë pa kufizim shume, të nevojshme apo të dobishme për arritjen e objektit të shoqërisë, apo që sidoqoftë kanë ngjashmëri me qëllimin e shoqërisë. Shoqëria mund të marrë kuota apo pjesëmarrje në shoqëri të tjera me objekt të ngjashëm ose të ndryshëm. Të marrë financime nga institute të ndryshme kredie, edhe nga shoqëri të tjera shtetërore apo private, duke dhënë garancitë e nevojshme imobiliare, reale dhe personale.
- 3.3 Shoqëria mund të kryej cdo aktivitet tjetër biznesi i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.
- 3.4 Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj në cdo kohë.



Kapitali themeltar dhe ndarja e tij

Neni 4.

4.1 Ortakët themelues:

- **Znj. Sonila Banda**, e bija e Albert-it, e lindur më 11/02/1974, banuese në Rruga Dum Alla 441, Tiranë, me kombësi Shqiptare, mbajtëse e kartës së identitetit me numër H45211117N, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar. **zotërues i një kuote të barabartë me vlerë nominale 100%.**

- 4.2 Kapitali i Shoqërisë do të jetë në total 100.000 (njëqind mijë) lekë, i përbërë nga 1 kuotë, me një vlerë nominale në përpjestim me vlerën e kuotës së zotëruar, plotësisht të nënshkruara dhe të shlyera nga Ortaku themelues.

Organet drejtuese dhe Administrimi

Neni 5.

- 5.1 Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga Administratori dhe organet e saj janë si më poshtë:
- Asambleja e Përgjithshme e ortakëve
 - Administratori
- 5.2 Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe të Administratorit do të përcaktohen në Statutin e shoqërisë.
- 5.3 Administratori i Shoqërisë do të jetë: Znj. Sonila Banda mbajtëse e kartës së identitetit me numër H45211117N, e cila e merr këtë detyrë për një periudhë 5 vjecare me të drejte rinovimi.

Dispozita Përfundimtare

Neni 6.

- 6.1 Çdo çështje tjetër, e cila nuk është përmendur në këtë Akt Themelimi, do të rregullohet nga dispozitat e Statutit të Shoqërisë, Ligjit për Shoqëritë dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.
- 6.2 Në rast mosmarrëveshje të cilat lindin si pasojë e këtij Akt Themelimi ose për shkak të ligjit, palët do të përpiqen ti zgjidhin ato miqësisht. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, mosmarrëveshja e palëve do të zgjidhet nga Gjykata e Shkallës së parë Vlorë.
- Ky Akt Themelimi hartohet dhe nënshkruhet nga Ortakët e Shoqërise, sot më datë 30.05.2025 në gjuhën shqipe në dy kopje.

ORTAKU THEMELUES

Znj.Sonila Banda

SONILA BANDA 